

Sipas informacioneve paraprake thuhet se nga ngjarja të paktën 19 persona kanë humbur jetën, ndërkohë që burime nga ushtria thonë se përplasja e armatosur vazhdon

ISLAMABAD(AA) - Në veri të Pakistanit, në kryqytetin e zonës Hayber-Pakthunkva, Peshaver ndërkohë që në xhami falej namazi i xhumasë nga një sulm me bomba të paktën 19 persona humbën jetën dhe 40 të tjerë u plagosën.

Ushtria pakistaneze përlëshet me atentatorët në ambjentet e xhamisë, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas zëdhënësit të policisë së Peshaverit ngjarja ka ndodhur në lagjen Hajatbad, ku militantët kanë sulmuar një xhami Shiite dhe se nga informacionet e para nga sulmi të paktën 19 persona kanë humbur jetën dhe 40 të tjerë janë

plagosur.

Grupi i armatosur pas sulmit vazhdoi qendrimin në xhami, ndërkoh në një kohë shumë të shkurtër shumë forca të sigurisë janë drejtuar drejt vendngjarjes. Ndërkohë theksohet se përleshja e armatosur vazhdon thuhet se personat e

armatosur kanë hyrë në xhami me uniforma policore.